



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit/Ured Premijera /Office of the Prime Minister

**Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur/ Vladina Komisija za Nestala Lica/ Governmental
Commission on Missing Persons**

Datë: 09 /08 /2024

THIRRJE PUBLIKE PËR PËRKRAHJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE TË CILAT MERREN ME ÇËSHTJEN E PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË LUFTËS NË KOSOVË

1. Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur/Zyra e Kryeministrit, u bënë thirrje të gjitha Organizatave Jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, që synojnë të kontribuojnë dhe angazhohen në procesin e ndriçimit të fatit dhe vendndodhjes së personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Me qëllim të lehtësimit në mbrojtjen dhe njohjen e çështjes së personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë, duke paraqitur projekte-programe, punëtori dhe trajtime të ndryshme të rehabilitimit psiko - social të familjarëve të personave të zhdukur, kurse të ndryshme trajnimi/ aftësimi, shënim të ditëve të veçanta/ rëndësishme , rrjedhimisht duke i involvuar në këto programe familjarët e personave të zhdukur, të aplikojnë për mbështetje financiare. Prioritet kanë OJQ-të që kanë bazë në komunitet, rrjedhimisht kontribuojnë në arritjen e qëllimit të interesit publik.

Qëllim dhe objektiv i kësaj thirrje publike, është shprehje dhe veprim konkret për të realizuar aktivitetet e synuara, që përbëjnë strategjinë institucionale të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur/ Zyrës së Kryeministrit (mëtej KQPZH/ ZKM), në zbatimin e misionit të tij. Misioni i KQPZH-së është të udhëheq, mbikëqyrë, bashkërendon dhe koordinon aktivitetet me institucione vendore , bashkëpunon me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, dhe akterë të tjerë , në lidhje me zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, si rezultat i luftës së viteve 1998-1999, pavarësisht përkatësisë etnike, religjionit apo statusit ushtarak apo civil .

Në këtë kuptim, KQPZH inkurajon dhe mbështetë të gjitha OJQ-të në Kosovë që merren me çështje /aktivitete të kësaj natyre, dhe përmes tyre familjarët e personave të zhdukur, që t'i mbrojnë të drejtat ligjore dhe liritë themelore të garantuara sipas legjislacionit në fuqi në Republikën në Kosovës.

Programi KQPZH/ ZKM konsiston në financim/ subvencionim të aktiviteteve të OJQ-ve që kanë për qëllim: ngritjen e vetëdijes së bashkëpunimit dhe mbrojtjes së të drejtave si më lartë, sensibilizimin e çështjes duke u angazhuar në këtë proces, në ide kreative për fitim te njohurive

të tjera të nevojshme jetësore dhe shoqërore , që të mund të integroheshin në rrjedhat shoqërore dhe në tregun e punës. Po ashtu t'iu mbaj të informuar lidhur me disa drejta/benificione aktualisht ligjore për këto kategori, si dhe, t'iu lehtësohet rehabilitimi psiko-social, dhe aftësimi/arsimimi i tyre profesional.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat me prioritet si në vijim:

- Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi në partneritet –profesional në mbrojtjen e të drejtave ligjore për familjarët e personave të zhdukur, për pjesëmarrje aktive në proces dhe për t'u informuar e pasur qasje në informacion, si dhe të drejtat e benificuara ligjore për familjarët e personave të zhdukur;
- Trajnime të bashkë - koordinuara për fusha të ndryshme profesionale-artizanale, si dhe mbështetja për kryerjen e praktikave profesionale për praktikantët në institucione dhe në biznese ;
- Organizime të aktiviteteve shoqërore në mbështetje të familjarëve të personave të zhdukur dhe rehabilitimit psiko-social ;
- Aktivitete sensibilizuese ;
- Aktivitete të ngjashme që ndikojnë në mirëqenien e familjarëve të personave të zhdukur .

3. OJQ-të mund të aplikojnë me një projekt apo në partneritet me organizata tjera (në një nga fushat si më lartë), ashtu që do të kontribuojnë përgjithësisht në projekte dhe programe shoqërore me interes publik **posaçërisht- adresimin e çështjes së personave të zhdukur në Kosovë, përmes aktiviteteve si më poshtë:**

- *Aktivitetet që kanë të bëjnë me organizimin dhe trajtim të temave psiko -sociale, me qëllim të rehabilitimit psiko-social dhe mbështetjes së familjeve të personave të zhdukur ;*
- *Aktivitete që synojnë avancimin e politikave qeveritare dhe procesit të zbardhjes së fatit të personave të zhdukur;*
- *Promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave ligjore dhe interesave të kësaj kategorie sa i përket kujdesit shëndetësor dhe social, punësimit apo benificionëve të tjera;*
- *Aktivitetet që kanë të bëjnë me krijimin e një rrjeti profesional, ku do të ofrohet organizimi i aktiviteteve të përbashkëta të anëtarëve të grupit (të rrjetit) dhe ku do të mund të ndahen /shkëmbehen informacione/përvoja mbi mundësitë e punësimit ose trajnimit, si dhe për të ndihmuar njëri tjetrin në avancimin e procesit të ndriçimit të fatit të personave të zhdukur.*
- *Aktivitete për zhvillimin / ngritjen e aftësive dhe mundësive ekonomike (trajnime të koordinuara-asociuara zëjtare-artizanale për familjarët e personave të zhdukur, dhe aftësimi i tyre në gjenerimin e të hyrave familjare);*
- *Aktivitete senzibilizuese- Ekspozita me fotografi/artistike të kësaj natyre-fushe brenda apo jashtë vendit, konferenca informative, shënimi i ditëve të veçanta*

4. Shuma e përkrahjes financiare e planifikuar për secilën OJQ është si në vijim:

Për mbështetje financiare publike për projektet/programet sipas kësaj thirrje publike është paraparë shuma në dispozicion në vlerë prej **60,000.00 (gjashtëdhjetë mijë) euro.**

Shuma e përkrahjes financiare për secilën OJQ individuale, apo në partneritet mes dy OJQ-ve, apo në partneritet të tri e më shumë organizatave për sa i përket financimit të projekt -propozimeve, është si në vijim:

Shuma minimale e mbështetjes financiare për çdo projekt individual është **2,000.00 (dy mijë)** euro, ndërsa **shuma maksimale** për një projekt individual është **4,000.00 (katër mijë)** euro. Për projektet që janë në **partneritet** në mes të dy e më shumë OJQ-ve, shuma minimale është **4,000.00 (katër mijë)** euro, ndërsa shuma e mbështetjes maksimale është **8,000.00 (tetë mijë)** euro.

Projektet mund të financohen në shumën 100% të totalit të kostove të pranueshme të projektit.

Aplikantët mund të sigurojnë bashkëfinancim edhe nga burime tjera të financimit.

Është obligative që në çdo formë të aplikimit të përcaktohet se cilës OJQ i aprovohet/dedikohet projekt-propozimi nga buxheti të cilit kërkohet të ndahen mjetet.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është pesëmbëdhjete (15) ditë pune duke filluar nga data 09.08.2024 dhe përfundon me datën 29.08.2024 në ora 16:00.

OJQ-të mund të aplikojnë më së shumti me një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje. Një OJQ, mund të jetë partnere në disa projekte në fushat me prioritet të thirrjes.

Periodha e zbatimit të projektit nuk mund të tejkalojë periudhën prej katër (4) muaj, nga nënshkrimi i kontratës.

6. Kriteret

- **Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të**, që janë të regjistruara në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës prej së paku 2 vite para datës së publikimit të thirrjes publike.
- **OJQ-të aplikuese duhet të argumentojnë/ dëshmojnë se**
 - Programi i tyre kontribuon në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave ligjore të personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre;
 - Angazhim të anëtarëve (familjarëve) të shoqatave në projekte dhe programe rehabilituese, si dhe organizimin e trajnimeve aftësuese për ta në profesione/zanate -artizanale të caktuara.
- **OJQ-të duhet po ashtu, të kenë kryer transaksionet financiare** në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit, të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare, dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
- **Para nënshkrimit të kontratës**, OJQ-ja duhet të paraqesë prova-dëshmi se personi përgjegjës në OJQ, dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me udhëzimet për aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare <https://kryeministri.rks-gov.net/konkurse-njoftime-dhe-shpallje/>

- Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë (jo me vonë se dita e mbylljes së thirrjes) në adresën e mëposhtme:

Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur / Zyra e Kryeministrit,
kati VI, Zyra nr. 604, Sheshi "Nëna Terezë" p. n., 10000 Prishtinë.

- Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

- Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike- mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, përmes email adresës: njesia.kqpzh@rks-gov.net

OJQ-të aplikuese duhet të plotësojnë formularët si në vijim:

1. Formulari i projekt-propozimit (shkarkohet online);
2. Formulari i propozim buxhetit (shkarkohet online);
3. Forma e deklaratës për financim të dyfishtë (shkarkohet online);
4. Formulari i deklaratës së partneritetit , nëse ka partneritet (shkarkohet online);
5. Forma e deklaramit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit, nëse ka (formulari shkarkohet online);
6. Deklaratë mbi aktivitetet e përshkruara për kontraktorët , nëse ka (formulari shkarkohet online) ;
7. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të OJQ-së dhe Numrit Fiskal ;
8. Kopja e Letërnjoftimit (e përfaqësuesit të autorizuar) dhe konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit ;
9. Dëshminë e penalitetit nga Gjykata për menaxherët e projekteve;
10. Certifikatë nga Administrata Tatimore e Kosovës në lidhje me gjendjen e borxhit publik të aplikuesit dhe partnerëve që vërteton se organizata nuk ka borxh, dhe në rast se ka borxh publik, duhet të paguhen para nënshkrimit të kontratës. Certifikata duhet të jetë lëshuar brenda periudhës që nga data e hapjes së thirrjes publike.

Formularët e nevojshëm mund të shkarkohen në: <https://kryeministri.rks-gov.net/konkurse-njoftime-dhe-shpallje/>